



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dëronar më Dostavljeno 11.02.2025		
Njësi.org. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë Prilog
06-500/02-0009432/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

# **Plani i punës për vitin 2025**

## Hyrje

Në Komunën e Podujevës Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale punën e organizon në shërbimet primare shëndetësore- Sektori i Shëndetësisë, shërbimet sociale- sektori i Mirëqenies Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale.

### Objektivat kryesore të DSHMS për vitin 2025

1. Përparimi, parandalimi, mjekimi shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet,
2. Edukimi shëndetësor, imunizimi dhe vaksinimi,
3. Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike.
4. Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik,
5. Rehabilitimin e bazuar në bashkësi,
6. Kujdesin shëndetësor riprodhues që përfshin kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave si dhe metodat e planifikimit të familjes,
7. Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse,
8. Sigurimi i ujit dhe ushqimi cilësor,
9. Kryerja e shërbimeve specialiste dhe diagnostiko-analizave laboratorike e rëntgenologjike, ultrasonike në kujdesin parësor shëndetësor,
10. Aftësimi mëtejshëm permanent i punëtorëve shëndetësor për punë në rrethana të jashtëzakonshme-emergjente në bazë të Ligjit për kujdesin shëndetësor emergjent.
11. Furnizimi me barëra dhe material sanitar nga Lista esenciale e barërave dhe furnizimi me barna dhe reagensa për nevojat e QKMF kontrata me buxhet të DSHMS
12. *Servisimi i pajisjeve mjekësore, Furnizim me dokumentacion mjekësor, Furnizim me material higjienik, Furnizim me pelet, Furnizim me naftë për ngrohje, Furnizim me naftë për vetura (shërbimi shtëpiak shëndetësor), Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit, Furnizim me oksigjen*
13. *Furnizim me pajisje mjekësore, Renovimi i objekteve shëndetësore*
14. Përmirësim të kushteve të banimit përfshinë pranimin e kërkesave dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit
15. Identifikimi i familjeve në teren lidhur me nevojat sociale ekonomike dhe të banimit, identifikimin e personave të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar.
16. Bashkëpunimi me MSH dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në gjithë segmentet ku është e mundur dhe i nevojshëm ai.
  - Bashkëpunimin me të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përfshirë organizatat qeveritare, joqeveritare, donatorë të ndryshëm dhe njerëzit e vullnetit të mirë.
  - Bashkëpunimi me MSH dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në gjithë segmentet ku është e mundur dhe i nevojshëm ai.

- Identifikimi i familjeve në teren lidhur me nevojat sociale ekonomike dhe të banimit, identifikimin e personave të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar.
- Puna e Qendrës për Punë Sociale mbështetët në idealet e humanitetit, barazisë, drejtësisë sociale si dhe përkushtimit ndaj qytetarëve, punëtorët janë të angazhuar që në mënyrë sa më profesionale të ofrojnë shërbime qytetarëve në nevojë të cilët në mënyrë të ndryshme kanë kërkuar shërbime.

## **Sektori i Shëndetësisë- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)**

### **Pjesa hyrëse**

Planifikimi i punës për vitin 2025 është i bazuar në legjislacionin aktual për shëndetësi, mundësitë, nevojat e popullatës, kapacitetet me resurse humane dhe hapësirat për zhvillimin e veprimtarisë mjekësore dhe jo mjekësore (trajnimet e ndryshme të stafit mjekësor).

Puna e QKMF - së bazohet në Ligjin mbi shëndetësinë e Kosovës, Ligjin e punës, Statutin e QKMF - së dhe Aktet tjera nënligjore të Ministrisë së shëndetësisë dhe rregulloret e brendshme.

Në vitin 2025 përkundër vështirësive dhe sfidave që do të kemi në punë ne si menaxhment i QKMF- së presim rezultate të arritshme në realizimin e obligimeve dhe objektivave si institucion shëndetësor dhe gjithë kjo duke u bazuar në angazhimin e të punësuarve në procesin e punës, ngritjen e nivelit të disiplinës në punë, riorganizimeve të brendshme në funksion të mbarëvajtjes së punës, konkretisht angazhimit maksimal të secilit të punësuar si në QKMF, QMF dhe AMF në teren.

Kusht i rëndësishëm për realizimin e suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me këtë plan pune, është jetësimi i plotë i detyrave që dalin nga Ligji për shëndetësi, Ligji i punës, Statuti dhe aktet normative në drejtim të realizimit dhe krijimit të kushteve për punë për stafin shëndetësor dhe shërbimin ndaj qytetarëve duke pasur për bazë:

- **kualitetin dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore**
- **kursim maksimal, racionalitet dhe modernizim të punës në bazë të të arriturave më të reja shkencore,**
- **pajisja me mjete të nevojshme dhe aparaturë mjekësore.**
- **përcaktimi real i nevojave dhe mundësive materiale në shëndetësi**

- **krijimi i kushteve për perfeksionim profesional, specializime, trajnime sipas planeve të posaçme dhe strukturës ligjore.**

Me këtë plan vjetor pune parashihen masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF, organizimi dhe udhëheqja, burimet njerëzore dhe plani financiar për këtë vit.

Veprimtaria e QKMF, QMF dhe AMF është që të bëjë ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor popullatës së komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror nëpërmes të zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare.

Koncepti i Mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës sonë t'iu ofroj kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për pacient në sistemin shëndetësor dhe njëheri pikë referuese për specialistet konsultativ në kujdesin parësor dhe në nivele tjera të kujdesit shëndetësor. Sipas strategjisë dhe standardeve të Mjekësisë familjare synohet që një mjek familjar së bashku me dy (2) infermiere do të ushtroj kujdes shëndetësor për 2000 banorë dhe 1. stomatolog dhe 2. teknik dental do të ushtrojnë kujdes oral stomatologjik për 6000 banorë, sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF, standard ky i synuar por vështirë i realizuar duke pasur parasysh numrin e lejuar të punësuarve, natyrën e shërbimeve si kujdesi urgjent, kujdesi shtëpiak, shërbimet teknike, shërbimet e higjienës të cilat na marrin jo pak staf jo mjekësor nga numri i lejuar i të punësuarve.

***QKMF- Podujevë kryen këto shërbime të Kujdesit Parësor Shëndetësor bazuar në konceptin e mjekësisë familjare:***

1. Parandalimi, mjekimi, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet,
2. Edukimi shëndetësor, imunizimi dhe vaksinimi,
3. Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike.
4. Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik,
5. Rehabilitimin e bazuar në bashkësi,
6. Kujdesin shëndetësor riprodhues që përfshin kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave si dhe metodat e planifikimit të familjes,

- 7.Zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse,
- 8.Kryerja e shërbimeve specialitike dhe diagnostiko-analizave laboratorike e rëntgenologjike, ultrasonike ne kujdesin parësor shëndetësor,
- 9.Aftësimi mëtejëm permanent i punëtorëve shëndetësor për punë në rrethana të jashtëzakonshme-emergjente në bazë të Ligjit për kujdesin shëndetësor emergjent dhe urgjent.
- 10.Furnizimi me barëra dhe material sanitar nga Lista esenciale e barërave dhe kontrata komunale

**Kujdesi parësor shëndetësor në QKMF zbatohet nga profesionistët shëndetësor:**

- 1.Specialistet e mjekësisë familjare
- 2.Doktori i mjekësisë
- 3.Doktori i stomatologjisë
- 4.Infermierët/et, mamitë, asistentët ose teknikët dentar, teknikët/et e laboratorit etj.

✓ **Kujdesi parësor shëndetësor përkrahet nga specialistet konsultant të QKMF,si:**

- 1.Specialisti i stomatologjisë.
- 2.Pediatri,
- 3.Gjinekologu-obstetër
- 4.Radiologu
- 5.Specialisti i Emergjencës
6. Epidemiologia

Në kuadër të mjekësisë familjare është edhe sistemi informativ shëndetësor,i cili grumbullon të dhënat shëndetësore të cilat dërgohen në IKSHP dhe DKPSh të MSh – së.

**Hapësira, Objektet shëndetësore, Organizimi i punës, Udhëheqja dhe kuadrot në QKMF**

**Hapësira-**

QKMF Podujevë veprimtarinë e vetë do ta ushtroj në dy objekte shëndetësore në qendër, në 3 objekte të QMF dhe me 18 objekte të AMF në teren. Vlerësojmë se hapësirat ekzistuese janë të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë shëndetësore respektivisht mbarëvajtjen e procesit të punës. Objektet shëndetësore i plotësojnë kushtet higjenik-teknike për ushtrim të veprimtarisë shëndetësore me përjashtim të AMF Horticë në cilën

duhet ndërhyrë në përmirësimin e kushteve dhe AMF Halabak nuk i plotëson fare kushtet për çka për momentin është jashtë funksioni.

### **Organizimi i punës, rrjeti i institucioneve shëndetësore, shërbimet dhe Udhëheqja**

Institucioni shëndetësor QKMF në Podujevë i formuar në territorin e komunës është formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse shëndetësore në nivelin parësor.

Veprimtaria shëndetësore është organizuar me qëllim të sigurimit të kujdesit të përshatshëm shëndetësor për qytetaret e komunës në kushte normale dhe në rrethana të jashtëzakonshme dhe në kushte emergjente. Duke siguruar kujdes shëndetësor për të gjithë dhe duke zbatuar masat dhe metoda bashkëkohore për veprimtari me interes të veçantë shoqëror.

Participimi në kujdesin parësor shëndetësor realizohet me tabelën e përcaktuar të çmimores të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Ministria e Financave për KPSH për grup moshat dhe kategoritë e ndryshme si: lirohen fëmijët deri në 15 vjeç, nxënësit, studentët, personat mbi 65 vjeç, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmoreve, invalidët e luftës, veteranët, familjet me asistencë sociale personat me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera të përcaktuara me rregullore.

Organizimi i punës bëhet në bazë të orarit mujor të punës për të gjitha njësitë organizative dhe shërbimet të cilin e përcakton drejtori i QKMF - së në fillim të çdo muaji.

Në kuadër të QKMF janë të organizuara këto Departamente-Njësi ose Sektorë, si vijon:

#### **Departamenti i Mjekësisë familjare:**

1. Sektori i Mjekësisë familjare, ( kujdestaria e natës, paliativi )

-Sektori i shëndetit publik.

-Njësia e SISH.

-Njësia e imunizimit dhe vaksinimit

-Sektori i shëndetit Oral.

-Urgjenca 24h.

#### **Sektori konsultativ-Specialistika**

-Pediatria

-Gjinekologjia – Materniteti

- Radiologjia

- Epidemiologjia

### Sektori i diagnostikes

- Kabineti radiologjik (Rtg, Vertebrogrami, ultrazëri, mamografia)
- Laboratori (Hematologjik dhe Biokimik)
- Baciloskopia

### Departamenti i administrates

- Njësia e personelit.
- Njësia juridike.
- Njësia për buxhet financa
- Njësia për shërbime teknike.

### C/Barnatorja Qëndrore -Furnizimi me barëra nga lista esenciale dhe kontrata komunale

#### ❖ Në kuadër të QKMF është i organizuar rrjeti i QMF dhe i AMF si vijon:

1. – Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) Podujevë
- 3 – Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF): Kërpimëh, Lluzhan Orllan
- 18 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF):Llaspashticë,Dumnicë, Gllamnik, Sfeçël,Shajkoc,Batlavë,Bradash,Majac,Bajqine,Pollate,Dobrtin,Herticë,Dyz,Lupç,Shtedim, Halabak, Lagja e Kuvajtit-Ballofc, dhe Obrançë.

### Kuadrot profesionale

Realizimi i detyrave të parashtruara me këtë program pune për vitin 2024 në rend të parë varet nga numri i nevojshëm i kuadrove profesionale në shëndetësi si Mjek specialist të MF, Doktorë të mjekësisë, Doktorë të stomatologjisë, Infermierë etj.

QKMF ne Podujevë si institucion shëndetësor nuk ka kuadër të mjaftueshëm mjekësor për të kryer funksionin sipas Ligjit mbi shëndetësinë në Qendër dhe Teren. Pra, tereni nuk ka qenë dhe nuk është i mbuluar sa duhet me kuadër shëndetësor, andaj për këtë arsye kemi nevojë për praninë edhe të një numri punëtorësh shëndetësor si vijon:

Nr.	Kuadri i nevojshëm	Numri
1.	Mjekë Familjar	Numri i mjekësve familjar sipas standardit për numër të banorëve mendojmë të arrihet me specializime të doktorëve të përgjithëm aktual që i kemi
2.	Stomatolog	1
4.	Teknik Rentgeni	1
5.	Teknik Dental	4
6.	Infermierë/e	2
7	Hixheniste	2
<b>Gjithsej :</b>		10

### **Shërbimet shëndetësore:**

Pritshmëria jonë është që të kemi rritje të shërbimeve shëndetësore në vitin 2025 kryesisht:

Urgjencë – hapësirat e mjaftueshme të objektit të ri, shtimi i stafit, funksionalizimi me aparatura të ndryshme të reja, trajnimi i stafit.

Laboratori – presim rritje të shërbimeve në laboratorin në qendër gjithashtu edhe në 4 laboratorët e tjera në teren (Lluzhan, Gllamnik, Kërpimëh, Orllan). Planifikimet tona janë që edhe në vitin 2025 të kryhen të gjitha ato analiza hematologjike dhe biokimike që janë kryer deri më tash dhe planifikohet të startohet edhe me kryerjen e troponinës në urgjencë dhe HbA1C në laboratorin e qendrës pas futjes së reagensëve në kontratën e re për furnizim.

Këshillimorja për Diabet dhe Hipertension pritet që të ketë shtim të shërbimeve të pacientëve me këto dy patologji ngase trajnimi i stafit, vetëdijësimi i qytetarëve, furnizimi me aparatura të nevojshme dhe material shpenzues janë indikator që qojnë në shtim pune. Synim i yni mbetet edhe hapja e shërbimit për trajtim të shputës diabetike por e gjithë kjo varet nga mundësitë e ofruara nga Ministria e Shëndetësisë për trajnim të stafit.



Do t'i kushtohet rëndësi të posaçme imunizimit – vaksinimit si masë profilaktike në parandalim të sëmundjeve infektive.

Këtë vit duhet kushtuar kujdes të veçantë realizimit të planit vjetor të imunizimit dhe të vaksinimit, e që synimi ynë është që përqindja e të vaksinuarve të jetë rreth 90%, duke u fokusuar edhe në prioritetet e imunizimit me vaksinat e reja.

Do të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve stomatologjike në QKMF dhe QMF Orllan, Lluzhan, Kërpimëh, Gllamnik dhe Urgjencë.

QKMF, QMF dhe AMF në teren veprimtarin e tyre themelore e ushtrojnë duke ofruar shërbime shëndetësore, qytetareve të komunës që kërkojnë ndihmën mjekësore. Planifikimi i shërbimeve shëndetësore në vitin 2025 bazohet në numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës, mundësive hapësinore të objekteve, potencialit kadrovik, patologjisë të sëmundjeve të popullsisë, epidemitë e ndryshme, gjendjet e jashtëzakonshme dhe emergjente nga fatkeqësitë elementare, epidemitë e ndryshme, lëndime dhe helmime masovike, tërmetet, zjarret, vërshimet, e që këto kanë ndikim në shtimin e numrit të shërbimeve shëndetësore. Pritshmëria jonë është se do të kemi rritje të shërbimeve duke pasur për bazë edhe shtimin e shërbimeve shëndetësore të cilat deri më sot nuk i kanë marrë qytetarët.

- **Planifikohet të vazhdojmë punën me dy ndërrime në QMF-Orllan, QMF Kërpimëh dhe QMF-Lluzhan ku në këtë të fundit mbetet synim zgjatja e orarit të punës, AMF-të do të vazhdojnë punën sipas orarit të rregulltë bazuar në dispozitat ligjore të UA për Shëndetësi.**
- **Do të vazhdojë puna në shërbimin e Kujdesit Paliativ prej ores 08:00- 23:00.**
- **Do të vazhdojë puna e vizitave shtëpiake për gratë shtatzëna dhe fëmijet 0-3 vjeq.**
- **Do të vazhdojmë me vaksinimin e të gjithë nxënësve të shkollave sipas kalendarit të vaksinimit.**
- **Do të vazhdohet me vizitat sistematike të nxënësve dhe të fëmijëve në qerdhet publike.**
- **Do të punohet në zonim të pacientëve, zgjedhje të mjekut familjar dhe orar pune çdo ditë me mjek në AMF.**

### **Shërbimet jo shëndetësore**

Në Departamentin e Administratës të kryhen të gjitha punët administrative-juridike dhe të kontabilitetit të QKMF nëpërmes zyrave të cilat janë njësi të saj. Do të kushtohet rëndësi e veçantë afarizmit materialo-financiar, pagesave, bashkë pagesave dhe të mbahen pasqyrat financiare sipas udhëzimeve dhe ligjit.

#### **- SISH – i Sistemi informativ shëndetësor i QKMF në Podujevë ( SISH-i ) gjatë vitit 2025**

Synim i yni mbetet funksionalizimi i SISH – it në vitin 2025 e që është synim për t'u dëshiruar ngase me infrastrukturën aktuale të SISH – it kjo thuhet të jetë e pa mundur. Është bërë studimi i fizibilitetit nga grupi punues i MSH – së për futjen e një operatori dhe programi të ri të SISH – it dhe shpresat tona mbesin këtu.

#### **Planifikimet për investime për vitin 2025 janë:**

1. Do të inicohen me kohë procedurat për sigurimin e kontratave komunale të cilat janë të domosdoshme dhe të parapara për funksionimin normal të mbarëvajtjes së punës së shërbimeve shëndetësore në QKMF.
2. Renovimi i garazhave dhe destinimi i tyre për nevoja të QKMF-së.
3. Renovimi dhe adaptimi i hapësirave ekzistuese për shërbimin e infuzioneve dhe kujdestarinë e natës (nëse ish objekti i Emergjencës destinohet për Shërbimin e Shëndetit Mendor).
4. Furnizimi me pajisje mjekësore (me prioritet aparat biokimik me kapacitet të shtuar të mostrave).
5. Furnizimi me inventar.
6. Furnizimi me Rëntgen të ri për nevoja të QKMF-së për çka është inicuar si projekt i paplanifikuar për shkak të defekteve të shumta të Rëntgenit aktual, kostos së lartë të mirëmbajtjes dhe rrezikut të mungesës së ofrimit të këtij shërbimi (vjetërsia e Rëntgenit aktual mbi 8 vite).
7. Ndonjë projekt eventual me rishikim të buxhetit në pjesën e dytë të vitit 2025

## UDHËHEQJA E QKMF

QKMF-në në Podujevë e udhëheq Drejtori i cili është menaxhues-udhëheqës. Drejtori i ka të gjitha autorizimet për përfaqësim juridik brenda veprimtarisë së QKMF-së. Është përgjegjës për afarizëm, e prezanton dhe e përfaqëson QKMF-në dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë. Drejtori e udhëheq punën profesionale të QKMF në bashkëpunim me Këshillin drejtues, Këshillin profesional dhe Kolegjiomet profesionale të njësisve organizative të QKMF.

Drejtori e zgjedh Këshillin Drejtues, si trup të QKMF. Drejtori e udhëheq Këshillin Drejtues. Drejtori zbaton Ligjin mbi shëndetësinë, Ligjin e punës, Statutin dhe aktet tjera normative të QKMF-së në Podujevë.

### **Këshilli Drejtues veçse ka formuar trupat profesionale:**

- Këshillin profesional
- Komisionin disiplinor,
- Komisionin për ankesa të QKMF,
- Komitetin për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore
- Komisioni etiko – profesional

Të gjitha këto trupa janë të parapara me statut të QKMF – së dhe të gjitha këto do të jenë funksionale dhe do t'i kontribuojnë mbarëvajtjes më të mirë të punëve.

E tërë veprimtaria e QKMF – së do të mbikëqyret nga brenda prej Drejtorit, Kryeshefit, Kordinatorit për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore dhe Kryeinfermierit.

Ndërsa mbikëqyrja e jashtme do të jetë konform dispozitave ligjore të Ligjit për Shëndetësi dhe UA për shëndetësi.

### **Pjesa materialo-financiare-Plani financiar**

Derisa gjatë vitit 2024 nuk kemi pasë pengesa të natyrës financiare për ushtrim të veprimtarisë së këtij institucioni bazuar në këtë praktikë dhe planifikimet për vitin 2025 shpresojmë se plani i ushtrimit të veprimtarisë së QKMF – së nuk do të hasë në pengesa të natyrës financiare.

Po theksojmë se me një organizim me të mirë të punës dhe në saje të angazhimit dhe përpjekjeve maksimale të të gjithë punëtorëve në realizimin e detyrave dhe punëve të planifikuara për këtë vit, realisht pritët shtimi i vëllimit të shërbimeve shëndetësore.

Ky plan pune edhe pse është i bazuar në tregues real, nuk mund të jetë real, sepse në këtë vit shtrohen edhe detyra pune që nuk i kemi planifikuar ose paraparë si në ofrimin e

shërbimeve të ndryshme shëndetësore, epidemitë e ndryshme, situata emergjente dhe të jashtëzakonshme dhe ndonjë situatë e pa planifikuar.

Detyrë parësore e secilit punëtor shëndetësor dhe punëtorëve tjerë dhe i shërbimeve do të jetë angazhimi maksimal për realizim e plotë të këtij plani të punës.

Një numër i madh detyrash që nuk janë paraparë me këtë plan pune, që do t'i imponoj koha dhe momenti dhe shpresojmë që QKMF do t'i kryej me sukses.

### **Shërbimet që ofrohen nëpër QMF-të dhe AMF-të në kuadër të QKMF-Podujevë**

Shërbimet që ofrohen QMF – Lluzhan , Kërpimëh, Orllan dhe AMF - Gllamnik:

Nr.	Shërbimet
1.	Shërbimet e mjekësisë familjare
2.	Shërbimi i sëmundjeve të dhëmbëve
3.	Laboratori
4.	Shërbimi i vaksinimit

Nr.	Shërbimet
1.	Shërbimi i mjekësisë familjare
2.	Shërbimi i vaksinimit

Projektet e planifikuara për vitin 2025

<i>Aktiviteti</i>	<i>Afati Kohor</i>	<i>Kosto financiare</i>
<i>Furnizim me pajisje mjekësore</i>	<i>Shkurt – Dhjetor 2025</i>	<i>80,000.00</i>
<i>Furnizim me Autoambulancë</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>60,000.00</i>
<i>Furnizim me pajisje</i>	<i>Shkurt – Dhjetor 2025</i>	<i>20,000.00</i>
<i>Furnizim me dokumentacion mjeksorë</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>55,000.00</i>
<i>Furnizim me Oksigjen</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>7,000.00</i>
<i>Furnizim me material higjenik</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>45,000.00</i>
<i>Furnizim me pelet</i>	<i>Shkurt – Dhjetor 2025</i>	<i>25,000.00</i>
<i>Furnizimi dhe servisimi i aparateve kunder zjarrit</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>5,000.00</i>
<i>Furnizim me inventar</i>	<i>Janar – Dhjetor 2025</i>	<i>10,000.00</i>

### Sektori për Mirëqenie Sociale

- Konsulta të vazhdueshme me palë për kërkesa të ndryshme, të cilat i evidentojmë si raste me prioritet për shqyrtim.
- Vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të familjeve aplikuese për subvencione shëndetësore dhe marrja e vendimit për t'iu ofruar ndihmë financiare momentale.
- Përkrahjen e OJQ-ve të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës, të cilat aktivitet kryesor kanë ofrimin e shërbimeve socio-ekonomike, të cilat për përfitimin e subvencioneve i nënshtrohen parimeve dhe dispozitave të përgjithshme dhe të veçanta të Rregullores së Ministrisë së Financave për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, që është në fuqi .
- Pranimin dhe regjistrimin e të gjitha kërkesave në bazën e të dhënave të familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike si dhe regjistrimin e përfituesëve në bazën e të dhënave.
- Bashkëpunimin me donator të ndryshëm, njerëz afarist dhe solidar, shoqata dhe organizata humanitare, për t'i përkrahur familjet me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike në Komunën e Podujevës me pako ushqimore dhe higjienike, mish, lavatriçe, shporetë për ngrohje me dru, furnizim me lëndë djegëse (dru për ngrohje), veshmbathje, hapjen e puseve me ujë të pijshëm etj.
- Vizitat në teren familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike sipas kërkesave të parashtruara.
- Shqyrtimin dhe përpilimin e listave prioritare për ndihmë familjeve me nevojë dhe me gjendje jo të mirë socio-ekonomike.
- Evidentimin dhe verifikimin sipas kërkesave të parashtruara nga familjet me të moshuar/a, vetmuar/a dhe hendikepuar/a duke i'u ofruar ndihmë në kuadër të mundësive të DSHMS-së.
- Vizitat ad-hoc të cilat bëhen mbi bazën e një kërkesë të caktuar.

### Strehimi

Plani i punës për banim dhe përmirësim të kushteve të banimit përfshinë pranimin e kërkesave dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit si dhe propozimet konkrete për përparësinë e këtyre familjeve për të ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës që nuk kanë mundësi të sigurojnë banim.

Plani i punës për banim për vitin 2025 ka këto objektiva:

- Vlerësimin e gjendjes së banimit të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve dhe në lagjen Shqipëtarët për Shqipëtarë,
- Vizitat dhe vlerësimin e gjendjes tek të gjitha familjet të cilat kërkojnë strehim, ndërtim të shtëpive, riparim apo pagesa për qera,
- Vazhdimi i punës në projektin në bashkëfinancim me Shoaqatë Jetimat e Ballkanit për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale,
- Bashkëpunimin me donatorë për të bashkë financuar projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për qytetare,
- Bashkëpunimi me Ministri për ndërtim dhe renovim të shtëpive për rastet sociale dhe familjet nga komunitetet,
- Bashkëpunimi me Ministrin për ndërtimin e banimit të përbalueshëm dhe banimit adekuat.

Prioritet kryesor i këtij plani është që gjatë kësaj periudhe Komuna e Podujevës të jetë në gjendje të ndihmojë familje duke ju siguruar strehim, ndërtim apo riparim të shtëpive në bashkëfinancim me donatorë apo duke paguar një pjesë të qerasë për rastet të cilat janë në kushte të rëndë socio ekonomike.

Në bazë të këtij plani do të bëhet regjistrimi dhe shqyrtimi i kërkesave të familjeve të cilët aplikojnë për banim apo përmirësim të kushteve të banimit në bazën e të dhënave, nga ku do të jetë më e lehtë qasja në kërkesat e tyre. Vizitat në shtëpi do të bëhen në mënyrë që të bëhet verifikimi i gjendjes së banimit dhe socio ekonomike.

**PLANI I PUNËS NË QENDRËN PËR PUNË SOCIALE NË PODUJEVË** Qendra për Punë Sociale në Podujevë funksionon në kuadër të tri shërbimeve të saja: Shërbimi Social-Familjar, Shërbimi i Asistencës Sociale, Shërbimi Administrativ-Financiar. Bashkangjitur gjeni raportin vjetor për këto tri shërbime si në vijim

### **SHËRBIMI SOCIAL Plani i punës për vitin 2025**

Shërbimi Social i Qendrës për Punë Sociale në Podujevë të gjithë veprimtarinë e tij e ushtron duke u bazuar në kornizën ligjore me të cilën funksionon ky shërbim. Duke u bazuar në Ligjin për Shërbime Sociale 08/L-255, Ligji i Familjes 2004/32, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve 06/L-084, Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, Udhëzimeve Administrative në fuçi, standardeve minimale për funksionimin e këtij shërbimi, konventa mbi të drejtat e fëmijëve, statutit të QPS-së.

Në Shërbimin Social të QPS-Podujevë bëhet trajtimi i rasteve të shumë kategorive e që për këto kategori ofrohen këto shërbime:

1. Kujdestaria për të mitur;
2. Kujdestaria për të rritur;
3. Kujdestaria për raste të veçanta;
4. Bashkimi familjar;
5. Adoptimi me element vendor;
6. Adoptimi me element ndërkombëtar;
7. Fëmijët në strehim familjar brenda familjes;
8. Fëmijët në strehim familjar jashtë familjes;
9. Fëmijët me nevoja të veçanta në strehim familjar;
10. Strehimi i përkohshëm në shtëpitë për strehim të përkohshmen;
11. Shërbimi për viktimat e dhunës në familje;
12. Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje;
13. Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
14. Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të krimeve seksuale;



15. Shërbimet për personat e rritur me çrregullime mendore;
16. Shërbimet për rehabilitim e re integrim të viktimave në familje e komunitet;
17. Shërbimet për fëmijët në konflikt me ligjin;
18. Bashkëpunimi me gjykatë – pjesëmarrja;
19. Mbikëqyrja e shtuar e Organit të Kujdestarisë;
20. Bashkëpunimi me institucione tjera të ndërlidhura me fëmijët në konflikt me ligjin;
21. Këshilla martesore në rastet e ndarjes së bashkëshortëve;
22. Këshillim në rastet e dhunës në familje të viktimës dhe kryesit të veprës;
23. Sanim i marrëdhënieve bashkëshortore;
24. Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve;
25. Dhënia e mendimit për martesën të miturve;
26. Shërbimi në realizimin e kontaktimit mes fëmijëve e prindërve të ndarë e shkurorëzuar;
27. Lëshimi i vërtetimeve mbi zotësinë e veprimit (armëmbajtje me leje, punësim, Odë të Avokatëve);
28. Lëshimi i vërtetimeve që nuk ka obligime ligjore ndaj palës së tretë në Kosovë;
29. Lëshimi i vërtetimeve mbajtës të fëmijëve;
30. Konstatim Zyrtar dhe një sërë shërbimesh të tjera.

Për të gjitha këto shërbime plotësohen format e punës me të cilat punon Shërbimi Social: (001,002,003, 004,005,006,007,008,009,010,010A, Deklaratë, intervistë për të mitur) dhe futen në Bazën e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, Baza e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, Baza e fëmijëve në Strehim Familjar.

Pas hapjes së rasteve dhe ndarjes së rastit për një sërë kategorish, Zyrtarët e Shërbimeve Sociale dalin në teren për verifikimin dhe trajtimin e këtyre rasteve, sipas standardeve dhe ligjeve në fuqi.

### **Asistenca Sociale - Plani i punës për vitin 2025**

Asistenca Sociale fushë veprimtarinë e saj e ushtron në bazë të ligjit 2003/15 dhe në ligjin Nr.04/L-96 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për skemën e ndihmave sociale të Kosovës dhe tekstin e të hyrave dhe të mirave materiale të llogaritshme dhe jo të llogaritshme, neni 12. i Udhëzimit Administrativ Nr.06/2013.

Në Shërbimin e Asistencës Sociale ofrohen këto shërbime

1. Pranimin e lëndëve të reja të kompletuara që paraqiten për Asistencë Sociale.
2. Verifikimin e lëndëve të reja në teren në Asistencë Sociale.
3. Dërgimin e lëndëve në komision mjekësor.

4. Dërgimin e lëndëve me ankesa për shkallën e dytë në DMS. Prishtinë.
5. Riverifikimin e shfrytëzuesve të Asistencës Sociale për kategorinë e parë në çdo vit dhe kategorinë e dytë çdo 6 muaj.
6. Udhëheqësi i Asistencës Sociale njofton palët për procedurat e kthimit të mjeteve financiare të ndihmës sociale të cilat familje figurojnë si tatim-pagues në ATK.
7. Lëshimin e librezave për shfrytëzuesit e Asistencës Sociale në Kategorinë e parë dhe të dytë.
8. Ri-aplikimin e shfrytëzuesve të Asistencës Sociale për kategorinë e parë në çdo një vit dhe pranimin e raporteve mjekësorë.
9. Ri-aplikimin e shfrytëzuesve të Asistencës Sociale në kategorinë e dytë në çdo gjashtë muaj dhe pranimin e deklaratave të papunësisë.
10. Lëshimin e Aktvendimeve për njohjen e së drejtës në Asistencë Sociale, apo mosnjohjen e të drejtës në asistencë sociale të nënshkuara dhe vulosura nga menaxheri i rastit dhe shefi i Asistencës Sociale.
11. Punimin e raportit një mujor tre, gjashtë, nëntë mujor dhe një vjeçar të shfrytëzuesve të asistencës sociale.
12. Kontrollimin e dokumentacionit të të gjitha lëndëve të shfrytëzuesve të asistencës sociale dhe nënshkrimin e lëndëve nga Udhëheqësi i Asistencës Sociale.
13. Pranimin e kërkesave për ndihmë momentale.
14. Propozimin e pëlqimit për autorizim në DMS dhe lëshimin e autorizimit për shfrytëzuesit e asistencës sociale pas dhënies së pëlqimit për autorizim, nga Departamenti i Punës dhe Mirëqenës Sociale.
15. Koordinimin e punëve me nëpunësinë e asistencës sociale dhe mbikëqyrjen e punës.
16. Lëshimin e librezave të kategorisë së parë dhe të dytë në asistencë sociale.
17. Ruajtja e dokumentacionit të palëve dhe konfidencialitetit me palët e tjera.

Podujevë, 11.02.2025

**Aprovuar nga:**  
Drejtoreshë e DSHMS  
Adelina Stublla





**Formulari per kerkese apo ankese**

Drejtorati/Njesia

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Data 11/02/2025

**1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

Emri dhe mbiemri

Drejtoria e Shendetësis dhe Mirëqenjes  
sociale

Numri personal

06

Adresa e vendbanimit

Zahir Pajaziti/

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit

Statusi i lëndës

Plani i punës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

06-500/02-0009432/25

Afati i zgjedhjes

13/03/2025

Vendimi

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Plani i punes per vitin 2025.

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

Nr. Lloji i dokumentit

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Drejtoria e Shendetësis dhe Mirëqenjes sociale vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Albana.Hyseni